

PROKURORIA PËR GJITHSHIMË
Nr. 68/11 Prot.
Datë 01.03.2021
DREJTORIA Halilvehi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SE SHKALLES SE PARE KAVAJE

Adresa: Lagja nr.5 Kavaje

Tel.Fax. 055-242250

Nr. 806 .Prot

Kavaje, më 26.02.2021

Lënda : Dergohet raporti per analizen vjetore viti 2020..

Drejtuar : PROKURORI I PËRGJITHSHEM
z. Olsian ÇELA
TIRANË

Bashkelidhur po ju dergojme raportin e analizes vjetore per vitin 2020, te Prokurorise prane Gjykares se Shkalles se Pare Kavaje.

Duke ju falenderuar.


DREJTUESI PROKURORISE

Artan MADANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KAVAJE



RAPORT-VJETOR

MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT

DHE VEPRIMTARINE E PROKURORISE PER VITIN 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KAVAJE

Adresa : Lagja nr.5 Rr"U.Qytetit"

Kavaje me 25.02.2021

R A P O R T – V J E T O R

**Mbi ushtrimin e veprimtarise te
Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje,
per vitin 2020.**

DREJTUAR
PROKURORIT TE PERGJITHSHEM

z. Olsian ÇELA

Raporti vjetor "Mbi gjendjen e kriminalitetit per vitin 2020" perpilohet ne permbushje te detyrimit ligjor bazuar ne nenin 50 te ligjit nr.97/2016 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise", duke e paraqitur para Prokurorit te Pergjithshem per miratim.

Ne kete raport pasqyrohen te dhena dhe shpjegime per gjendjen e kriminalitetit, numrin, llojin, shtrirjen, tendencen, itensitetin dhe format e kriminalitetit ne juridiksionin e Prokurorise Kavaje, por se pari ne frymen e zbatimit te :

- Rezolutes "Per vleresimin e veprimtarise se organit te Prokurorise per vitin 2020" miratuar me date 18.06.2020 nga Kuvendi i Shqiperise.
- Planit te veprimit, Per zbatimin e Rekomandimeve te Rezolutes se dates 18.06.2020 "Per vleresimine veprimtarise per vitin 2020" miratuar nga Prokurori i Pergjithshem.
- Rekomandimeve Prioritare "Ne luften kunder kriminalitetit per vitin 2020", sipas percaktimeve kryesore te parashikuara ne V.K.M nr.501 date 24.06.2020.
- Udhëzimin e përgjithshem nr.10/2020 'Për masat administrative dhe proceduriale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".
- Memorandumin e Bashkëpunimit nr.1079, dt.15.07.2020 'Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimeve financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e asetëve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të LKSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF'

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje ka ushtruar veprimtarine e saj ne respektim te dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato qe burojne nga marreveshjet nderkombetare te ratifikuara me ligj nga Kuvendi i RSh, por dhe ne vleresim te udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem.

Ne ushtrim te detyrave dhe perballimin e ngarkeses gjate vitit 2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje pamvaresisht organikes (6-Prokurore + Drejtuesi dhe 2-Of/Pol/Gjyq), ka patur efektivisht ne perberje 5- Prokurore (D.Bedini, M.Meta, E. Kurti. Sh.Duro, G.Çopa,) dhe Drejtuesi (A.Madani), dhe 2-oficere te policise gjyqesore (F.Bajramaj dhe A.Elezi), si dhe 6-punonjes te administrates.

Fillimisht, nenvizojme faktin e vleresimit maksimal te raportit ligjor institucional, ne lidhje me angazhimin e Prokuroreve sa i perket prioriteteve te percaktuara ne V.K.M, material i cili eshte njohur dhe diskutuar ne mbledhjen e Prokuroreve, duke percaktuar drejtimet kryesore te punes.

Referuar percaktimeve te prioriteteve ne luften kunder krimin, eshte bere kujdes ne evidentimin e rasteve te referuara, problematikave te tyre, planifikimin dhe percaktimin e dinamikes se veprimtarise hetimore, ne hetimin marrjen e provave dhe caktimin e masave te sigurimit, deri ne zgjidhjen perfundimtare te ceshtjeve.

I. Ne luften kunder korrupsionit.

Nje nder prioritetet kryesore nga rekomandimet e percaktuara ka qene ndjekja per vitin 2020, e luftes kunder korrupsionit.

Ne vleren e shifrave, ne ndryshim nga viti 2019, kete vit evidentohen keto raste te kallzimeve penale nga sherbimet e policise apo axhensite e tjera ligjzbatuese.

- Konkretisht Prokuroria Kavaje ka hetuar ceshtje të mbartura nga viti 2019 gjithsej 4-ceshtje, dhe konkretisht 1-ceshtje per nenin 259 te K.Penal, dhe 3-ceshtje per nenin 287/ te K.Penal,
 1. Ceshtja nr.39 regjistruar me date 01.02.2019, per nenin 259 te K.P, referuar nga Sherbimi i Kontrollit te Brendeshem i Burgjeve, per veprime abuzive dhe korruptive nga ish- drejtori IEVP Rrogozhine. (Kallzimi penal ben fjale per veprimtari te kundraligjeshme te Drejtorit te IEVP Rrogozhine para se te lirohej nga detyra. Kryer veprime hetimore me pergjim.
Çeshtja nr.39, eshte dërguar ne gjykim, më pas nga Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë është vendosur kthimi i akteve në lidhje me hetimin dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore dhe me dt.14.04.2020 ky procedim penal është transferuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë.
 2. Ceshtja nr.238 regjistruar me date 18.06. 2019, per nenin 259 - 248 - 283/ te K.P, referuar nga Sherbimi i Kontrollit te Brendeshem te Drejtorise se Pergjithshme te Policise, per veprime abuzive dhe korruptive nga subjekti K.M oficer Policie ne Kom.Pol.Kavaje. Kryer veprime hetimore proaktive.
Çeshtja me dt.14.01.2020 eshte transferuar per kompetence PPKKO Tirane.
 3. Ceshtja nr.379 regjistruar me date 03.09.2019, per nenin 259 te K.P, referuar nga DÇB Ankesave Tirane ndaj subjekteve F.K dhe B.P (punonjes te policise Tirane) per veprime abuzive dhe korruptive .

Çeshtja me dt.14.01.2020 eshte transferuar per kompetence PPKKO Tirane.

4. Ceshtja nr. 199 regjistruar me date 21.05.2019, per nenin 257/a te K.P, referuar nga ILDKPKI ndaj subjektit B.N (ish-kryetar i Bashkise Rrogozhine)
Kjo ceshtje është pushuar me dt.24.07.2020.

Per nenin 248 te K.Penal, rezultojne 8-ceshtje penale te regjistruara për vitin 2020 dhe 19-ceshtje penale te mbartura ngaviti 2019.

Kallzime te ardhura: 11- nga sherbimet e Policise, 2- nga K.L.Sh , 4- nga DSHKB Burgjeve, 2- nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, dhe 1- nga IKMB dhe 7-nga shtetas.

Nga keto ceshtje 3-ceshtje jane derguar per gjykim, 5-pushuar, 19- ne hetim.

Sqarojme se rezultojne dhe 5-procedime penale te regjistruara si per vepren penale te parashikuar nga neni 248 te K.P, si edhe per vepra penale te tjera si 186/ , 164/a dhe 150 te K.P.

Nuk rezultojne kallzime dhe ceshtje te regjistruara per nenin 190/ te K.Penal (per shkak te ligjit te dekriminalizimit)

II. Ne luften kunder krimet te organizuar.

Per shkak te kualifikimit ligjor te ketyre veprave (kompetences sipas nenit 75/a te K.Pr.P), Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje, ka hetuar ceshtje qe duhen konsideruar derivate te krimet te organizuar.

Ne kete veshtrim po paraqesim te dhena ne lidhje me veprat penale qe kane te bejne me pastrim produktesh, lendet narkotike, dhe armembajtje pa leje.

~ Per nenin 283/... te K.Penal, per vitin 2020 rezultojne te regjistruara 30-ceshtje penale, dhe të mbartura 11-ceshtje.

Konkretisht me 24-persona ne hetim, nga keta 4-me mase sigurimi “arrest ne burg” dhe 5-“detyrim paraqitje” .

5-ceshtje derguar per gjykim, 8-ceshtje pushuar (*sasira te vogla dhe perdorues*), 2-ceshtje pezulluar, ndersa 26-ceshtje rezultojne ne hetim.

Pergjithesisht rastet per nenin 283/1 rezultojne me sasira te vogla, ne formen e mbajtjes dhe perdorues.

~ Per nenin 284/.. te K.Penal jane regjistruar 2-ceshtje penale te cilat jane ne hetim.

Per nenin 287/ te K.Penal, aktualisht jane ne hetim 3-procedime penale, të mbartura nga viti 2019.

Për vitin 2020 nuk ka ardhur asnje referim nga shërbimet e policisë apo të Drejtorisë së Pastrimit të Parave për nenin 287/ të K.Penal.

Konkretisht çështja penale me nr. 250 regjistruar me 24.06.2019 subjektet rezultojnë të dënuar për trafik narkotikesh nga autoritetet e Huaja. Çështja penale është në hetim.

Çështja nr. 431, regjistruar me datë 30.09.2019, subjekti dyshohet se është dënuar në Itali për trafik lëndesh narkotike. Është dërguar leter-porosi autoriteteve Italiane për të konfirmuar statusin e subjektit, çështja është në hetim.

Çështja nr. 170, regjistruar me datë 28.04.2017 dhe me dt.03.12.2020 ky procedim është dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë me kërkesë për pushimin e çështjes.

III. Për forcimin e respektimit të drejtave të njeriut të subjekteve të procedimit penal.

Në bazë të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” është krijuar seksioni për të mitur, duke caktuar një Prokuror dhe një Of/Pol/Gjyqësore, duke patur parasysh ngarkesën e vogël për veprat penale me të mitur në juridiksionin që mbulon Prokuroria Kavajë.

Rezultojnë 8-çështje penale me subjekte autor të mitur nëni 291 si edhe viktime të mitur 5-çështje.

Jane vlerësuar maksimalisht të gjitha rastet, në respektim të procedurave ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur duke u aplikuar dhe shmangia nga dënimi për personat autor të mitur dhe në të gjitha rastet për nenin 291 të K.Penal.

Në asnjë rast nuk evidentohet pavlefsheri aktesh procedurale, sa i përket respektimit të detyrimeve ligjore, të prezencës së Avokatit, Psikologut apo prindërve, si dhe të zbatimit të drejtë të caktimit të masave të sigurimit.

Evidentojmë 26-çështje të regjistruara për veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a.. të K.Penal.

Në gjykim 10-çështje, pushuar 4-çështje, në hetim 12-çështje.

Masat e sigurimit për nenin 130/a/... të K.Penal rezultojnë: 12- arrest në burg, 14-gjendje të lire.

Një risi në trajtimin e këtyre çështjeve, është pjesëmarrja gjatë veprimeve hetimore e Kordinatorit të emëruar tashmë si pjesë e organikes së Prokurorisë.

IV. Per forcimin e bashkepunimit nder-institucional.

Me sherbimet e policise vendore takimet ne frymen e bashkepunimit kane qene ne dinamike, por eshte marre takim dhe me Drejtues te Sh.I.Sh, duke ju shprehur gatishmerine per bashkepunim institucional ligjor.

Bashkepunim ligjor-procedural korrekt eshte mbajtur me drejtorite prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, ne veçanti dhe dinamike me Drejtorine e Marredhenieve Juridiksionale me Jashte, sa i perket rasteve te ekstradimeve.

Rezultojne 9-raste te kerkesave per ekstradim dhe njohje vendimi penal te huaj, te cilat jane proceduar ne respektim te afateve procedurale dhe pa problematika ligjore.

Ne keto procedura evidentojme dhe bashkepunimin efektiv me Ministrine e Drejtesise.

- Evidentojme nje nivel bashkepunimi ligjor dhe efektiv me Prokurorine e Pergjithshme, ne frymen e procedurave te rivleresimit profesional kalimtar te Prokuroreve, por dhe te korespondencave me prioritet dhe ne kohe, ne funksion te verifikimit te integritetit te personave, ne funksion te procesit te dekriminalizimit.
- Eshte proceduar me urdhera te brendeshem nga Drejtuesi i Prokurorise, sipas percaktimeve te ligjit 97/2016 'Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne R.Sh' ne lidhje me funksionimin e sistemit elektronik te ndarjes se çeshtjeve, per nje zgjidhje me objektivitete te shperndarjes se çeshtjeve, dhe krijimin e nje klime te pamvaresise se Prokuroreve ne ndjekjen e çeshtjeve, pa iu shmangur kontrollit ligjor te respektimit te procedurave hetimore.
- Evidentojme nje pjesemarrje ne dinamike sipas aplikimeve te gjitha trupes se Prokuroreve, ne seminarat tematike prane Shkolles se Magjistratures, lidhur me njohurite dhe implementimin e ndryshimeve ligjore, te procedures penale, te cilat kete vit kane qene ne nje numer te reduktuar per shkak te situates se pandemise Covid-19.
- Eshte vleresuar ne nivel te kenaqshem, respektimi i standarteve etike dhe profesionale ne funksion te forcimit te integritetit te Prokuroreve, duke respektuar kuadrin ligjor te ngritjes se problematikave ne çeshtje, nepermjet takimeve (mbledhjeve ne dinamike) trajtimit te rasteve te diskutuara nepermjet procedurave ligjore te pasqyruara ne akte, ne raport me Drejtuesin apo me subjektet e perfshire ne çeshtje.

Perdorimi i formes se marrjes se proves nepermjet pergjimeve dhe vezhgimeve ne hetimet proaktive:

8-kerkesa per pergjim telefonik te miratuara nga Gjykata.

2-pergjime ambientale te vleftesuara nga Gjykata.

1-rast me kerkese derguar Gjykates për kontroll banese të miratuar nga Gjykata.

1-rast Urdher vzhgimi

Format e Gjykimit:

3- urdhera penal (te miratuara)

26-kerkesa per gjykim me marreveshje. (23-miratuar)

Jane regjistruar 506-proçedime penale, dhe 345-vendosur mosfillimi, 12-referime ne faze verifikimi per mosfillim te mbartura per vitin 2021, te cilat kane perfunduar me vendim mosfillimi, pra 357-mosfillime.

Ushtrimi i veprimtarise hetimore nga O/P.Gjyqesore;

Kryer hetime mbi bazen e urdhërave të delegimit sipas neneve 34 te K.Pr.Penale, nga Of/pol/gjyqesore te Prokurorise per 183 -proçedime penale.

Sqarojme se ne numrin 357-mosfillime kryesisht veprimtaria verifikuese eshte kryer nga Prokuroret dhe O/Pol/Gjyq te Prokurorise.

Kryer hetime nga sherbimet e policise Gjyqesore te Komisarariatit te Policise Kavaje 252-proçedime penale, nga of.pol/burgjeve 38- proçedime penale.

Duhet evidentuar disa problematika konkretisht :

- Duhet evidentuar fakti i nje trendi ne renie te referimeve nga sherbimet e Policise apo axhensite e tjera, per veprat penale te natyres korruptive, apo te pastrimit te produkteve te vepres penale.
- Referimet ne pergjithesi rezultojne te pa plota, te pa materializuara me akte apo dokumente te mjaftueshme te dhenash ligjore per evidentimin e fakteve penale, per te regjistruar çeshtjet.
- Cilesia e referimeve dhe perpilimi i akteve, rezulton ne kufij minimale nga sherbimet e policise.
- Ne vleresimin e ngjarjeve te karakterit te rendesishem, kerkohet menjehere pergjimi i subjekteve te dyshuar apo personave qe te tjere qe kontaktojne, pa kryer veprime konkrete te mjaftueshme, apo pa verifikuar statusin e personave dhe saktesine e mjeteve komunikuese qe perdorin, apo te kryerjes se veprimeve te planifikuara dhe legjenduara sipas nje plani hetimore per te qene konkret, eficient, ne bashkepunimin per evidentimin dhe marrjen e provave.
- Nje fakt qe duhet evidentuar eshte se ne asnje rast nuk referohen paligjshmeri nga vete Zyrat e Regjistrimit te Pasurive, apo nga auditet qe kryhen ne keto zyra, pra te krijohet bindja qe ato funksionojne ne nje pamvaresi te plote dhe ne mungese te nje kontrolli, si nga hierarkia nga varen apo dhe K.L.Sh. Mendoj se kontrolli i ketyre zyrave nga strukturat perkatese do te perbente nje indicie shume te forte per paligjshmerite e subjekteve ne formalizimin e pasurive, por dhe te pergjegjesise se punonjesve te ketyre zyrave.
- E njetja situatë mud te themi se ekziston dhe ne Institucionet e tjere. Pra mungojne kallzime nga Institucionet, te cilat natyrshem kane sektore auditimi. Te gjitha rastet e evidentuara ne regjistrat e Prokurorise burojne nga veprimtari e policise apo rastet mediatike.
- E njetja situatë eshte evidentuar edhe ne statistiken e vitit te kaluar por duhet ritheksuar dhe per vitin 2020, qe per vepra penale te natyres korruptive, shperdorimit te funksionit jane ne nje nivel te ulet. Referimet apo kallezimet nga Institucioent audituese, agjensite ligjzbatuese duke mbetur vetem ne shifrat e kallezimeve nga qytetaret.
- Evidentimi i fakteve kriminale dhe referimi i tyre, rezulton pothuajse gjithnje nga sherbimet e policise, pra referimi fakteve kriminale eshte ende ne nivel te ulet nga Institucionet.

- Evidentohet nje zvarritje ne kthimin e pergjigjeve nga Institucionet vendore, por dhe kthimi i pergjigjeve eshte ne nje nivel modest profesional.
- Ne kuadrin e profesioneve te lira jane krijuar shume shoqata dhe zyra ekspertesh. Mendoj se duhet krijuar nje listim i tyre nga institucionet e licensimit dhe regjistrimit te tyre. Fjala eshte per ekspertet autoteknike, apo dhe ato te fushes piroteknike. Mendoj se specialistet e zjarrefikesve, apo ato te fushes se elektricitetit rezultojne ne kualifikime modeste per juridiksionin qe mbulojne.
- Nuk ka referime dhe kallzime penale ne fushen e sigurise ushqimore apo te fshehjes se te ardhurave apo tatimeve. (Referuar nivelit te informalitetit)
- Nisur nga problematika e evidentuar nga ana jone ne analizen per vitin 2019, e cila ka gjetur rregullimin e posaçem me Memorandumin e Mirëkuptimit për Zbatimin e Nenit 59 të K.Pr.Penale ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dt.30.09.2020, Udhëzimi i Përgjithshëm nr.15, dt.30.10.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, kjo ka bere krijimin e nje shtate tjeter te reduktimit te referimeve nga sherbimet e policise.
- Mbi bazen e kryerjes se veprimtarise verifikuese tashme kallezimet penale ndjekin nje procedure verifikimi e cila vleresohet nga sherbimet e policise dhe nuk referohen apriori ne Prokurori, gje qe bente rritjen artificiale te trajtimit te rasteve duke krijuar edhe nje mbingarkese tek prokuroret.

Por referuar dinamikës së punës në teresi, ngarkesës në hetim, por veçanërisht të asaj në gjykim, mendoj se rastet e referuara janë trajtuar me kujdes dhe objektivitet, treguesit rezultojnë pozitiv në zgjidhjen e çështjeve si nga pikepamja profesionale, por dhe treguesve të tjere, të shpejtesisë në hetim, politikave objektive dhe të drejta të raportit të të kesave të Prokurorisë dhe vendosjes së masave të sigurimit ndaj autoreve nga Gjykata, por dhe në aspektin e perfaqesimit në Gjykate të çështjeve, me qendrimeve të mbajtura deri në masat e denimit, të perfaqesimeve në Gjykate të numrit të konsiderueshem të kerkesave të denuarve nga I.E.V.P Rrogozhine (*nenet 64 dhe 59/a K.P, si dhe bashkimet e denimeve*)

Analiza e punës së organit të Prokurorisë në përgjithësi dhe asaj në veçanti të çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqësore, do ta realizonim duke ju referuar të dhenave statistikore 1-vjeçare që analizojmë pra vitit 2020.

I. Volumi i akteve të referuara (kallzime penale nga sherbimet e policise, nga Institucionet dhe qytetaret).

Jane regjistruar (*protokolluar*) në sekretarinë e Prokurorisë Kavaje, referime për vepra penale për vitin 2020, 863-materiale (103-me pak se 2019) nga keto 781- të referuara nga sektoret e sherbimeve të Pol.Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Kavaje, 2-materiale kallzuese nga Institucionet, 42-materiale kallzuese nga qytetaret, si dhe 38-çështje penale të ardhura me kalim aktësh për kompetence nga Prokuroritë e tjera.

Ne krahasim me vitin e meparshem rezulton nje renie te kallzimeve nga Institucionet, nga 88/2019 ne 40/2020. Evidentojme se nga K.L.Sh ka vetem 2-kallzime penal, ne lidhje me auditin ne Bashkine Kavaje dhe Rrogozhine, çeshtje te cilat jane ne hetim, dhe 1-kallzim nga ILDKPKI.

Pra evidentohet nje tendence ne zbritje e numrit te pergjithshem nga viti i 2019, te referimeve per fakte dhe ngjarje kriminale ne teresi, gje qe do te analizohet nga treguesit konkrete dhe per grup veprash penale.

Evidence e Referimeve dhe kallzimeve te regjistruara ne Prokurori

Viti	Referime nga sherbimet e policise	Kallzime nga Institucionet	Kallzime nga shtetasit	Gjithsej
2018	838	42	53	933
2019	816	88	50	954
2020	781	40	42	863

Te gjitha rastet e akteve te referuara apo kallzimeve te paraqitura jane trajtuar me pergjegjesi, duke i evidentuar ne regjistrat perkates, duke marre vendime perkatese ligjore, regjistrimi apo mosfillimi te çeshtjes penale sipas rastit.

Nga kallezimet penale dhe referimet e protokolluara ne sekretari dhe regjistrin perkates ne **357-raste eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal** ne baze te nenit 290/-291/ te K.Pr.Penale (nje zbritje nga viti i kaluar prej 30-raste), ku ne 2019 ka patur 387-mosfillime.

Ndersa **eshte vendosur regjistrimi per 506- çeshtje penale** (nga 564 per vitin 2019, pra 58 - çeshtje te rregjistruara me pak se nje vit me pare).

Viti	Referime kallzime	Mosfilluar	Regjistruar
2018	933	353	547
2019	954	387	564
2020	863	357	506

Me qarte veprimtaria e Prokurorise do te rezultoj duke **analizuar treguesit sipas dinamikes se trajtimit gjate hetimeve dhe vendimarrjes** referuar dhe praktikes procedurale qe ndiqet, nga momenti i konstatimit te veprave penale nepermjet vend-ngjarjeve, kallzimeve penale etj, trajtimit ne aspektin ligjor, shpejtesise ne hetim etj, qe te krijonim nje tablo sa me te qarte te pasqyrimin te rezultateve apo mangesive dhe problematikave te evidentuara.

II. MOSFILLIMET (sipas neneve 290/-291/ te K.Pr.Penale)

Eshte vendosur mosfillimi i proçedimit penal ne baze te neneve 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale, per **357-referime aktesh.**

Sa i perket tendences te natyres se veprave penale te referuara, ne numrin 357-te vendimeve te mosfillimit rezultojne ne numer te konsiderueshem si me poshte :

- per nenin 89 te K.Penal jane 20-vendime mosfillimi,
- per nenin 90 te K.Penal jane 51-vendime mosfillimi,
- per nenin 84 te K.Penal jane 29 vendime mosfillimi,
- per nenin 99 te K.Penal jane 19-vendime mosfillimi,
- per nenin 130/a/ te K.Penal jane 8-vendime mosfillimi,
- per nenin 277 te K.Penal jane 12-vendime mosfillimi,
- per nenin 199/a/1 te K.Penal jane 21-vendime mosfillimi.
- per nenin 290/1 te K.Penal jane 18-vendime mosfillimi.
- per nenin 134/1 te K.Penal jane 16-vendime mosfillimi.
- per nenin 143/1 te K.Penal jane 9-vendime mosfillimi.
- per nenin 150 te K.Penal jane 8-vendime mosfillimi.
- per nenin 151 te K.Penal jane 5-vendime mosfillimi.
- per nenin 161 te K.Penal jane 19-vendime mosfillimi.
- per nenin 200 te K.Penal jane 6-vendime mosfillimi.
- per nenin 248 te K.Penal jane 20-vendime mosfillimi.
- per nenin 283 te K.Penal jane 2-vendime mosfillimi.

Ne te gjitha rastet, ne arsyetimin e vendimeve eshte bere dhe orientimi per t'ju drejtuar Gjykates per raste konkrete me padi civile, apo ankim direkt ne Gjykate sipas nenit 59 te K.Pr.Penale.

Ne te gjitha rastet e mosfillimit te çeshtjeve jane bere njoftimet e vendimeve te mosfillimit paleve te interesuara gje qe evidentohet si nga korespondenca e shkreses ashtu dhe kopjet e vendimeve te konfirmuara dhe te administruara ne fashikujt perkates.

Nga 357 - vendime mosfillimi, **jane ankimuar 9-vendime** prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje, per te cilat per 2 - raste eshte vendosur prishja e vendimit te mosfillimit, per 7 - raste ankimi eshte lene ne fuqi vendimi mosfillimit te Prokuroreve.

Duhet evidentuar fakti se nje pjese e madhe e kallzimeve per te cilat eshte vendosur mosfillimi, jane kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke argumentuar plotesisht shkaqet e mosfillimit.

Evidence permbledhese e akteve ne faze verifikimi (Mosfillimet)

Regjistruar ne faze verifikimi per 2018	Mosfilluar	Mbartur ne 2019	Ankuar	Dinamika e zgjidhjes
386	353	33	20	<ul style="list-style-type: none"> ➤ 7-prishur (rifilluar) ➤ 13-lene ne fuqi

Regjistruar ne faze verifikimi per 2019	Mosfilluar	Mbartur ne 2020	Ankuar	Dinamika e zgjidhjes
402	387	15	24	<ul style="list-style-type: none"> ➤ 7-prishur (regjistruar çeshtja) ➤ 11-lene ne fuqi ➤ 6-ne gjykim
Regjistruar ne faze verifikimi per 2020	Mosfilluar	Mbartur ne 2021	Ankuar	Dinamika e zgjidhjes
357	345	12	9	<ul style="list-style-type: none"> ➤ 2-prishur (regjistruar çeshtja) ➤ 7-lene ne fuqi

- Pra referuar evidences se mesiperme rezulton se eshte bere nje pune e mire ne lidhje me trajtimin e materieleve fillestare, ku ankimimet vetem per 24-vendime mosfillimi nga 357 materiale kallzuese, eshte nje tregues domethenes per cilesine e vendimarrjes se mosfillimeve
- Duhet evidentuar fakti se eshte respektuar afati 15-ditor (*sipas ndryshimeve ligjire me ligjin nr.35/2017*)
- Por duhet evidentuar fakti se rezultojne referime te akteve me mangesi (te dukshme), apo raste te konflikteve te pronesise qe kane te bejne me administrim te praktikave administrative apo gjyqesore per te bere nje konkludim te sakte ne vendim, si dhe vonesat ne konfirmimet e akteve te ekspertimit mjeko-ligjor, gje qe ka bere qe ne disa rate te urdherohet regjistrimi ne pritje te akteve te ndryshme, konfirmimeve te priteshme.

III. CESHTJE PENALE TE REGJISTRUARA DHE HETUARA.

Ne vitin 2020 jane regjistruar gjithsej **506-çeshtje penale**.

Te mbartura nga viti 2019 **216-çeshtje penale**, dhe **10-çeshtje te ri-filluara hetimet**.

Pra per vitin 2020 rezultojne **722-çeshtje penale te hetuara**. (11-proçedime te bashkuara ne 4-proçedime)

- ✓ Kane perfunduar hetimet gjithsej per **407-çeshtje penale**.

Pra nga numri i pergjithshem i kallzimeve penale dhe i ceshtjeve te regjistruara rezulton se gjate kesaj periudhe ka patur nje ulje te kallzimeve dhe ceshtjeve penale te regjistruara dhe hetuara.

Evidence e ceshtjeve te regjistruara dhe hetuara

Viti	Mbartur nga viti para -ardhes	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Perfunduar
2018	159	547	707	548
2019	148	564 (+ 14-te rifilluara)	726	503
2020	216	506 (+ 10-te rifilluara)	722	407

Kjo shpjegohet per shkak te situates se krijuar dhe nga demtimet e termetit nentor 2019 (si nje zone e perfshire) por dhe situates se pandemise Covid-19.

DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PERHAPJES SE VEPRAVE PENALE NE PERGJITHESI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NE VEÇANTI.

Sa i perket tendences se natyres kriminalitetit, te perhapjes se veprave penale ne pergjithesi apo me grup veprash penale te veçanta rezulton se veprat penale me nje shtrirje dhe perhapje me te madhe jane ato te :

kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike me 312 - proçedime penale. (bashke me te mbartura)

Evidentojme se

- ✓ per nenin 134/ te K.Penal 239-proçedime penale,
- ✓ per nenin 199/a/- te K.Penal 28-proçedime penale,
- ✓ per nenin 137/ te K.Penal 12-proçedime penale,
- ✓ per nenin 143/ te K.Penal 14-proçedime penale,
- ✓ per nenin 150 te K.Penal 3-proçedime penale.
- ✓ per nenin 151 te K.Penal 8-proçedime penale.
- ✓ per nenin 161 te K.Penal 8-proçedime penale.

➤ **kunder autoritetit te shtetit, respektivisht 158 - proçedime penale**

Nga keto

- ✓ per neni 248 K.Penal 28-proçedime penale, (8-regjistrime, 18-te mbartura dhe 2-rifilluara)
- ✓ per neni 283/1,2 K.Penal 35-proçedime penale, (27-regjistrime, 8-te mbartur)
- ✓ per neni 290/ K.Penal 22-proçedime penale, (13- regjistrime, 9-te mbartura)
- ✓ per neni 291 K.Penal 73-proçedime penale (58-regjistrime, 15-te mbartura)

- Veprat penale te drejtuara **kunder jetes se personit dhe shendetit rezultojne se jane regjistruar 15 - procedime penale.** (nje renie e ndjeshme krahasuar me vitin 2019)

Nga keto

Kunder jetes personit asnje çeshtje penale

- ✓ per nenin 76 te K.Penal 1-çeshtje penale,
- ✓ per nenin 89 te K.Penal 9-çeshtje penale,
- ✓ per nenin 84 te K.Penal 1-çeshtje penale,
- ✓ per nenin 99 te K.Penal 4-çeshtje penale,

- Veprat penale te drejtuara **kunder femijeve, marteses dhe familjes rezultojne se jane regjistruar 26-procedime penale.**

- ✓ per nenin 130/a/.. te K.Penal (nje rritje e lehte krahasuar me vitin 2019)

- Veprat penale te drejtuara **kunder veprimtarise shteterore, rezultojne se jane regjistruar 4-procedime penale.** (vepra penale te natyres korruptive)

IV. MENYRA E PERFUNDIMIT TE ÇESHTJEVE.

(Personat ne hetim, masa sigurimit, pushimet, pezullimet dhe te derguara per gjykim)

Kane perfunduar hetimet dhe eshte konkluduar ne vendim perfundimtar per 407 çeshtje penale per vitin 2020, duke mbartur ne hetim 313-çeshtje penale per vitin 2021.

Rezulton se nga **407 - çeshtje te perfunduara:**

- 141 - çeshtje jane derguar per gjykim,
- 78 - çeshtje jane pushuar,
- 176 - çeshtje jane pezulluar,
- 2 - çeshtje jane transferuar per kompetence
- 313 - çeshtje jane mbartur per vitin 2020.

Tabele permbledhese

Mbartur nga 2016	Regjistruar ne 2017	Hetuar	Gjygit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim ne - 2018
140	628	780	244	144	200	18	171
Mbartur nga 2017	Regjistruar ne 2018	Hetuar	Gjygit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim ne - 2019
159	547	707	193	109	234	12	159
Mbartur nga 2018	Regjistruar ne 2019	Hetuar	Gjygit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim ne - 2020
148	564	726	165	113	225	23	199
Mbartur nga 2019	Regjistruar ne 2020	Hetuar	Gjygit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim ne - 2021
216	506	722	141	78	176	2	313

• **PERSONA NEN HETIM, DHE MASAT E SIGURIMIT**

Regjistruar emri si person nen hetim.

Ne keto proçedime penale rezulton se eshte regjistruar emri per 267 - persona me cilesine e te dyshuarit per nje veper penale ne urdherin e regjistrimit, pra me cilesine ndaj te cileve zhvillohen hetime.

Nga keta kane perfunduar hetimet per 147 - persona,

- ku 133-personave u jane njoftuar akuzat perkatese, njoftimit te akuzes neni 34 K.Pr.P“ dhe jane derguar per gjykim,
- per 2 - persona nen hetim eshte vendosur transferimi i proçedimeve penale,
- per 12 - persona eshte vendosur pushimi i çeshtjes penale ne ngarkim te tyre,
- per 125 - persona nen hetim jane mbartur per vitin 2021.

Masat e sigurimit .

Nga personat nen hetim mbi bazen e referimit te akteve paraprake kane ardhur me mase shtrenguese te vendosur nga sherbimet dhe seksioni i Pol/Gjyqesore, “arrest ne flagrante“ 86- persona te dyshuar dhe 2-ndalime, gjithsej 88- persona me mase shtrenguese.

Eshte kerkuar vleftesimi i arrestit ne flagrante dhe ndalimit per 88- persona te dyshuar.

Gjykata per 86- raste ka vleftesuar te ligjshem masat shtrenguese.

Ndersa per 1- arrestim dhe 1- ndalim ka vendosur vleftesimin e paligjshem.

Nga **Prokuroria** eshte kerkuar caktim mase sigurimi 90-persona te dyshuar, ku eshte kerkuar masa e sigurise si me poshte :

- **36-te dyshuar “arrest ne burg“** sipas nenit 238 te K.Pr.Penale,
- **2- te dyshuar „arrest ne burg“ ne mungese** sipas nenit 238 te K.Pr.Penale.
- **3-te dyshuar “arrest ne shtepi”** sipas nenit 237 te K.Pr.Penale,
- **49-te dyshuar “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore“** sipas nenit 234 te K.Pr.Penale.

Nga **Gjykata** eshte vendosur **caktim mase sigurimi** per :

- 29 - persona “arrest ne burg”,
- 7 - persona “arrest ne shtepi”,
- 50 - persona masa e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore”.

Te dhenat permbledhese per autoret dhe masat e sigurimit

Per vitin 2018.

Regjistruar emri nen hetim	Te pandehur (njotuar akuza)	Masa sigurimit				Gjykim	Pushuar	Transferuar	Ne hetim
		Neni 234	Neni 236	Neni 237	Neni 238				
295	231	79	1	2	44	231	19	7	38

Per vitin 2019.

Regjistruar emri nen hetim	Te pandehur (njotuar akuza)	Masa sigurimit				Gjykim	Pushuar	Transferuar	Ne hetim
		Neni 234	Neni 236	Neni 237	Neni 238				
288	183	68	1	4	56	183	24	22	59

Per vitin 2020.

Regjistruar emri nen hetim	Te pandehur (njotuar akuza)	Masa sigurimit				Gjykim	Pushuar	Transferuar	Ne hetim
		Neni 234	Neni 236	Neni 237	Neni 238				
267	133	49	0	3	36	141	78	2	125

Me poshte po analizoje menyren e perfundimit te ceshtjeve te regjistruara dhe hetuara, dhe konkretisht.

a) CESHTJE TE DERGUARA NE GJYKATE

Pas perfundimit te hetimeve jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje **141-procedime penale me 167 - te pandehur.**

Nga te cilet me mase sigurimi "Arrest ne Burg" jane derguar per gjykim 36-te pandehur.

Duke ju referuar veprave penale per te cilen jane akuzuar e derguar per gjykim te pandehurit, rezulton si me poshte :

- Per vepren penale **kunder autoritetit te shtetit** (kunder veprimtarise shteterore-kunder rendit dhe sigurise nenet 235-299 te K.P) jane derguar per gjykim **50 - procedime penale me 54 - te pandehur ku nga keto 6 - te arrestuar.**
- ✓ *Per vepren penale te "Mosbindja ndaj punonjesit te policise se rendit" neni 242 i K.Penal 3-procedime penale me 3-te pandehur.*
- ✓ *Per vepren penale te "Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor" neni 290/ i K.Penal 3-procedime penale me 3-te pandehur.*
- ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 291 te K.Penal jane derguar per gjykim 34- procedime penale me 34-te pandehur.*
- ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 273 te K.Penal jane derguar per gjykim 1- procedime penale me 1-te pandehur.*
- ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 283/ te K.Penal jane derguar per gjykim 5- procedime penale me 8-te pandehur.*
- ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 248 te K.Penal jane derguar per gjykim 4- procedime penale me 5-te pandehu.*
- Per veprat penale **kunder pasurise 134/ - 200 te K.Penal** jane derguar per gjykim 13 - **procedime penale, me 17-te pandehur ku nga keto 10-te pandehur te arrestuar.**
Pra evidentohet nje renie e ketyre veprave penale te derguara per gjykim ne krahasim me vitin 2019.

Evidentojme se per:

- ✓ *nenet 134/1,2 te K.Penal 10-procedime me 14-te pandehur ku nga keto 10-te arrestuar,*
- ✓ *neni 137/1,2 i K.Penal 1-procedime me 1-te pandehur,*
- ✓ *neni 186/1,2 te K.Penal 1-ceshtje me 1-te pandehur.*
- ✓ *neni 143/1,2 te K.Penal 1-ceshtje me 1-te pandehur.*

- Per veprat penale te seksionit te fallsifikimit te dokumentave nenet 190/ te K.Penal (ne lidhje me kallzimet ne kuader **te ligjit per dekriminalizimin**) nuk rezulojne çeshtje penale.
- Per veprat penale **kunder jetes dhe shendetit se personit** nenet 76-133 te K.Penal jane derguar per gjykim 14 - proçedime penale, me 14-te pandehur ku nga keto 5-te arrestuar.
- Pra evidentohet nje renie e ndjeshme e ketyre veprave penale.

Evidentojme se per:

- ✓ *per nenin 88 jane derguar per gjykim 1-çeshtje me 1-te pandehur, 1 arrestuar.*
- ✓ *per nenin 76 jane derguar per gjykim 7-çeshtje me 1-te pandehur, 1 arrestuar.*
- ✓ *per nenin 89 jane derguar per gjykim 4-çeshtje me 4-te pandehur, 1 arrestuar.*
- ✓ *per nenin 130/a/... jane derguar per gjykim 10-çeshtje me 10-te pandehur me 4- me mase sigurimi arrest ne burg.*
- Per veprat penale **kunder drejtesise** nenet 300-324/a te K.Penal jane derguar per gjykim 15- proçedime penale, me 19- te pandehur ku nga keto 5-te arrestuar.

Evidentojme se:

- ✓ *per nenin 324/a/1 te K.Penal jane derguar per gjykim 12-proçedime penale me 16-te pandehur ku 3-jane me mase sigurime "arrest ne burg,*
- ✓ *per nenin 300 te K.Penal eshte derguar per gjykim 1- çeshtje penale me 1 - te pandehur,*
- ✓ *per nenin 318 te K.Penal 1-ceshtje 1-pandehur*
- ✓ *per nenin 323 te K.Penal 1-ceshtje 1-pandehur 1-arrestuar(ne mungese)*

Forma e gjykimit.

- Kerkesa per gjykim te zakonshem nga Prokuroria 115 – kerkesa gjykim te zakonshem.
- Kerkesa per miratim te marreveshjes nga Prokuroria 26 – kerkesa me marreveshje, 23-miratuar, 3-pa perfunduar/gjykim.
- Urdhera – penal, 3-çeshtje (miratuar)

b) CESHTJE PENALE TE PERFUNDUARA GJYKIMI PER VITIN 2020

Gjate vitit 2020 pas dergimit te çeshtjeve penale per gjykim, ka perfunduar gjykimi per 115-proçedime penale me 119-te pandehur .

Nga Prokuroria

- Per 69- te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim.
- Per 41-te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim dhe pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim (neni 59 K.Penal) duke perfshire ketu dhe nenin 63 te K.Penal.
- Eshte kerkuar denimi me gjobe per 5-te pandehur.

Nga Gjykata ne lidhje me kerkesat e bera nga Prokuroria qe parashtruam me siper eshte vendosur

- Deklarimi fajtor per 114 te pandehur (nga 115 te kerkuar nga Prokuroria).
- Eshte vendosur denimi me burgim per 64 - te pandehur (nga 69-te kerkuar nga Prokuroria)
- Eshte vendosur denimi sipas nenit 59 dhe 63 te K.Penal per 47-te pandehur.
- Eshte vendosur denimi me gjobe per 3-te pandehur.

Evidentojme faktin qe nje pjese e madhe e denimeve me kusht (pezulluar ekzekutimin e denimit me burg neni 59 K.P) dhe detyrimet per te bere nje pune me interes publik (neni 63 te K.P) kane te bejne me vepra penale te parashikuara nga nenet 291 dhe 199/a/1 te K.penal.

- Eshte vendosur denimi me gjobe per 3 te pandehur (nga 5-te kerkuar nga Prokuroria)

Siç shikohet nga statistika e mesiperme raporti i kerkesesave per mase denimi te Prokurorise me vendimet e dhena nga Gjykata rezulton nje raport pa ndryshime thelbesore si ne llojin ashtu dhe ne masen e denimit.

Ne kete veshtrim jane analizuar dhe qendrimet per apelim me kete raport ndryshimesh te kerkesave dhe dhenies se vendimeve.

- Ne seance paraprake nuk ka asnje rast te pushimit te çeshtjes.
- Eshte vendosur pafajesi per 1-te pandehur (1-çeshtje).

Por duhet evidentuar dhe nje numer i konsiderueshem gjykimesh, mbi bazen e kerkesave te *denuarve me objekt "lirim me kusht" neni 64 K.Penal, qendrim ne shtepi" neni 59/a K.Penal, si dhe kerkesat per njohje Amnistie.*

Kemi parasysh se Gjykata Kavaje ka ne juridiksionin e saj I.E.V.P Rrogozhine.

Rezulton se jane trajtuar ne gjykim 153 – kerkesa me objektet kerkese sipas neneve 64 – 59/a/ te K.Penal, bashkime denimesh, ri-vleresim mase mjekesore, heqje zotesise per te vepruar, llogaritje denimi etj.

Konkretisht :

- ✓ Me objekt sipas nenit 64 te K.P jane 71-kerkesa.
- ✓ Me objekt sipas nenit 59/a te K.P jane 14-kerkesa.
- ✓ Me objekt sipas nenit 55 dhe me objekt llogaritje denimi, shuarje mase denimi njohje Amnistie etj rezultojne 68-kerkesa.

Duhet sqaruar dhe evidentuar se 85-kerkesa, te kaluara per gjykim, me nje llogaritje te thjeshte me minimum seancash, rezulton ne mbi 250- seanca gjyqesore, plus dhe seancat per gjykimet me objekt tjeter sa me siper. Pra mbi 300-seanca gjyqesore me çeshtje me subjekte te denuarit e IEVP Rrogozhine.

Pra eshte nje mbingarkese e perballuar nga Prokuroret, pervec çeshtjeve te dinamikes te derguara ne gjykim me objekt pushimin apo gjykimin ne themel te pandehurve.

Evidentojme dhe 93-kerkesa per pushimin e çeshtjeve me parashkrim sipas nenit 66/ te K.Pr.Penale,(pas ndryshimeve ligjore te dates 01.08.2017).

Duhet evidentuar fakti, qe ka nje mbingarkese te perfaqesimit ne seancat gjyqesore.

Ankimet ne Gjykatën e Apelit

Nga çeshtjet e gjykuara dhe te perfunduara ne Gjykatën e Rrethit e Gjyqesor Kavaje ne 9 - raste eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Durres.

Nga te cilat :

- ✓ 4-ankime ndaj vendimeve perfundimtare (themelit)
- ✓ 2- ankime ndaj masave te sigurimit (1-pranuar, 1-mospranim)
- ✓ 3-ankime me objekt kunder shuarjes denimi, pranimit te Amnistise, llogaritje te paraburgimit. (2-ankime mospranuar, 1- ankim per lpk pranuar)

c) PROCEDIMET PENALE TE PUSHUARA

Gjate ketij viti nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje eshte vendosur pushimi per 78- procedime penale.

Prokuroria :

- Per 24 – çeshtje eshte vendosur pushimi ne Prokurori (kundravajtjet penale, dhe me heqje dore) sipas nenit 328 te K.Pr.Penale.
- Per 54 – çeshtje eshte kerkuar miratimi i kerkeses per pushim ne Gjykate.

Gjykata;

- Per 44 – çeshtje Gjykata ka vendosur miratimin e kerkeses per pushim.
- Per 10 – çeshtje nuk eshte miratuar kerkesa per pushim nga Gjykata, dhe jane kthyer per ri-hetime.

Duke ju referuar statistikes rezulton se :

Per 23-proçedim penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/a (fakti nuk ekziston) te K.Pr.Penale.

Per 6-proçedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/dh te.K.Pr.Penale (per mungese provash).

Per 25-proçedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/b te.K.Pr.Penale (fakti nuk perben veper penale, kryesisht per nenin 290/2 te K.P).

Per 24 - proçedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/c – 286 K.Pr.Penale (heqja dore nga ankimi) kryesisht per nenet 275,89, 84 K.P.

Per rastet e tjera proçedime penale jane pushuar per shkaqe te tjera, kryesisht qe u perkasin neneve 290/, 150, 161, 199/a, 273, te K.Penal.

Duke ju referuar grup veprave penale per te cilat eshte rregjistruar proçedimi rezulton se eshte vendosur pushimi si me poshte :

Konkretisht

- | | | |
|---------------------|------------|-----------------------|
| ✓ per nenin 248 | te K.Penal | 5-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 290/1,4 | te K.Penal | 9-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 199/a/1 | te K.Penal | 3 - proçedime penale. |
| ✓ per nenin 130/a/1 | te K.Penal | 2- proçedime penale. |
| ✓ per nenin 89 | te K.Penal | 5- proçedime penale. |
| ✓ per nenin 283/1 | te K.Penal | 6- proçedime penale, |
| ✓ per nenin 84 | te K.Penal | 3- proçedime penale. |
| ✓ per nenin 275 | te K.Penal | 1-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 151 | te K.Penal | 1-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 277 | te K.Penal | 1-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 161 | te K.Penal | 1-proçedime penale. |
| ✓ per nenin 99 | te K.Penal | 1-proçedime penale. |
| ✓ Per nenin 186/1 | te K.Penal | 3-procedime penale. |

Duhet evidentuar se jane pushuar dhe çeshtje per vepren penale te “Ndertim i paligjeshem” parashikuar nga neni 199/a/1 te K.P, te cilat realisht ne fazen e pare jane regjistruar per shkak te paqartesive ne referim, me mangesi te veprimeve te para hetimore nga sherbimet e Policise, per te cilat ka lindur e domosdoshme kryerja e ekspertimeve teknike, per konkludimin e sakte nese jemi para vepres penale apo kundravajtjes administrative.

Ne lidhje me pushimet per vepren penale te "Dhunes ne familje" parashikuar nga neni 130/a/..te K.P, rezulton se me teper jane rastet kur duhej treguar kujdes, per hetimin e plote te rrethanave te rastit, si çeshtje qe ne shume raste rezultojne problematike, te ndjeshme, por dhe te diskutueshme sa i perket kualifikimit.

Ankimet ndaj vendimeve te pushimit nga kallzimetaret/viktimat.

Nuk ka asnje ankim ndaj vendimeve te pushimit per vitin 2020, te vendosura nga Prokuroret sipas nenit 328/1 te K.Pr.Penale (kundravajtjet, qe vendoset direkt nga Prokurori)

Per 11 – çeshtje nuk eshte miratuar kerkesa per pushim nga Gjykata, dhe jane kthyer per ri-hetime, nga te cilat, 1- çeshtje eshte ri-derguar perseri por per gjykim me te pandehur, ndaj 1- çeshtje është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, 1-çeshtje është ridërguar për gjykim, ndërsa 8-çeshtje jane ne ri-hetim.

d) PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA

Eshte vendosur pezullimi i hetimeve ne baze te nenit 326/1,2 te K.Pr.Penale per 176 - procedime penale te cilat jane te ndara me grup veprash:

- Vepra penale kunder pasurise rezultojne 143 - procedime penale.(neni 134/ .. te K.P) Keto procedime penale kryesisht jane me vend-ngjarje te referuara nga seksionet e policise gjyqesore prane Komisarjatit te Policise Kavaje.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar kryerja e veprimeve hetimore si dhe deleguar veprime specifike, dhe ne perfundim bazuar dhe ne relacionin e oficerëve te policise gjyqesore eshte vendosur pezullimi i hetimeve.

Ne kuptimin e figurave te krimit te ketyre grup veprave penale duhet nenvizuar se per nenin 134/ te K.Penal rezulton pjesa me e madhe e tyre.

e) PROCEDIMET PENALE TE TRANSFERUARA

Eshte vendosur trasferimi per kompetence tokesore dhe lendore per 3 - procedime penale rast pas rasti per kompetence tokesore Prokurorive perkatese.

Ne asnje rast te shpalljes se moskompetences dhe kalimit te akteve nuk kemi patur konflikt per zgjidhjen e kompetences drejtuar Zyres se Prokurorit te Pergjithshem.

Pra evidentojme faktin qe vendimet kane gene te arsyetuara dhe te bazuara ne dispozitat proceduriale per kompetencen.

IV. SHPEJTESIA ME HETIMET PARAPRAKE DHE AFATET E PARABURGIMIT

Nga treguesit kryesor te veprimtarise se punes se Prokuroreve dhe trupes se of/pol/Gjyqesore te Prokurorise dhe sherbimeve prane Komisarariatit te Policise Kavaje, eshte shpejtesia e veprimeve hetimore ne hetimet paraprake e cila ka te beje ne respektimin e dispozitave proceduriale penale per afatet e hetimit dhe ne veçanti ato te paraburgimit me te pandehur te arrestuar . Rezulton se pergjithesisht jane respektuar kriteret e afateve te hetimit.

Rezulton se gjate hetimeve paraprake eshte kerkuar zgjatja afati hetimor per **24- çeshtje penale nga 722-çeshtje te hetura gjithsej.**

Konkretisht eshte kerkuar zgjatje e afatit te hetimit per:

- 17-procedime zjatje penale afati 1-3 muaj ,
- 7- procedime penale zgjatje afati 3-6 muaj .

Ne lidhje me **afatet e paraburgimit nuk ka asnje rast te kalimit te ketyre afateve** , per rrjedhoje **nuk kemi asnje kerkese drejtuar Gjykates per zgjatjen e afatit te paraburgimit.**

Duhet evidentuar fakti se jo rralle zgjatjet jane vendosur per shkak te zvarritjes se veprimeve nga sherbimet e pol.gjyqesore te cilat kane relatuar me vonese per dinamiken dhe gjendjen e hetimeve.

Por eshte detyre e Prokurorit qe here pas here ne dinamike te kerkoje dosjet, dhe ne rastet e konstatimit te mungeses se veprimtarise hetimore te relatoje tek Drejtuesi per kalimin ne proces disiplinor.

Por duhet evidentuar se per shkak te zevendesimeve te Prokuroreve, te cilat kane gene te detyrueshme disa zgjatje afati hetimesh (per shkak te largimeve), qe kane krijuar hapësira dhe nderprerje te dinamikave te hetimeve.

V. EKZEKUTIMI I VENDIME PENALE

Ne vitin 2020 jane nxjerre nga Prokurori i ekzekutimeve te vendimeve penale **190 - urdhra ekzekutimi vendimesh penale**, te dhena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Kavaje.

Nga keto 47 - urdhëra ekzekutimi te denimit me burgim , 14 - urdhëra denimi me gjobe, 79 - denime alternative (kusht), 7 - pune me interes publik sipas nenit 63 te K.P , si dhe 2 - urdhëra per mjekim te detyrueshem sipas nenit 46 te K.Penal dhe 8-raste rivleresim te kushteve te mases mjekesore dhe 18- urdhëra per lirim para kohe me kusht sipas nenit 59/a dhe 64 te K.Penal.

Gjithashtu jane edhe 15-urdhëra ekzekutimi të ndryshme që përfshijnë bashkim dënimesh, heqje sekuestro, llogaritje dënimi, njohje e ditëve te burgut, njohje vendimi penal te huaj, perfitim nga amnistia, shpallje i zhdukur, shuarje denimi dhe zgjatje afati te sherbimit te proves.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar dhe ekzekutimi i shpenzimeve procedurale.

Ndersa ne lidhje me ekzekutimin e vendimeve me gjobe ne çdo rast jane evidentuar praktikat nga Zyra e Permbarimit ku eshte drejtuar urdheri i ekzekutimit.

VI. Veprimtaria dhe ngarkesa e Prokuroreve dhe Of/Pol/Gjyqesore.

Por per te qartësuar veprimtarin, punen individuale per çdo Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqesore po paraqesim dhe treguesit per secilin ne veçanti :

Prokurori Artan Madani

Hetuar -	113- proçedime penale
Mosfillime –	37 kallzime
Derguar ne gjyq –	20 proçedime penale
Pushuar –	9 proçedime penale
Pezulluar –	50 proçedime penale
Transferuar -	0 proçedime penale
Mbartur -	34 proçedime penale
Zgjatje afatesh-	2 – proçedim penale.

Prokurori Durim Bedini

Hetuar -	186 proçedime penale
Mosfillime –	109 kallzime
Derguar ne gjyq –	39 proçedime penale
Pushuar –	15 proçedime penale
Pezulluar –	41 proçedime penale
Transferuar -	0- proçedime penale
Mbartur -	89 proçedime penale
Zgjatje afatesh -	3- proçedime penale.

Pjesemarrje ne gjykim me objekt kerkese :

- ✓ sipas nenit 64–59/a- 46 te K.P – 22-gjykime
- ✓ perfitim nga amnistia 3-gjykime
- ✓ njohje e kohës së paraburgimit 1-gjykim
- ✓ sipas nenit 19/ (parashkrimet) te K.P
- ✓ sipas nenit 504-512 te K.Pr.P ekstradime-njohje vendimi te huaj – 2-gjykime

Prokurori Edina Kurti

Hetuar -	170 proçedime penale
Mosfillime –	119 kallzime
Derguar ne gjyq –	27 proçedime penale

Pushuar –	21 proçedime penale
Pezulluar –	44 proçedime penale
Transferuar -	1 proçedime penale
Mbartur	77 proçedime penale
Zgjatje afatesh -	4 proçedime penale.

Pjesemarrje ne gjykim me objekt kerkese :

- ✓ sipas nenit 64–59/a- 46 te K.P – 18-gjykime
- ✓ është ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë për nenin 64 të K.Penal ku Gjykata e Apelit Durrsë ka vendosur sipas kërkesës së Prokurorit.
- ✓ sipas nenit 59 (te demtuar akuzues) te K.P – 2-gjykime
- ✓ perfitim nga amnistia 3-gjykime
- ✓ sipas nenit 66/ (parashkrimet) te K.P – 24-gjykime
- ✓ sipas nenit 504-512 te K.Pr.P ekstradime-njohje vendimi te huaj – 2-gjykim

Prokurori Gezim Çopa (Prokurori i ekzekutimeve te vendimeve penale)

Hetuar -	142 proçedime penale
Mosfillime-	78 kallzime
Derguar ne gjyq –	42 proçedime penale
Pushuar –	30 proçedime penale
Pezulluar –	16 proçedime penale
Transferuar –	0- proçedime penale
Mbartur-	67 proçedime penale
Zgjatje afatesh -	7 proçedime penale

Pjesemarrje ne gjykim me objekt kerkese :

- ✓ sipas nenit 64–59/a- 46 te K.P – 12-gjykime
- ✓ sipas nenit 59 (te demtuar akuzues) te K.P – 2-gjykime
- ✓ sipas nenit 66/ (parashkrimet) te K.P – 17
- ✓ sipas nenit 504-512 te K.Pr.P (ekstradime-njohje vendimi te huaj – 4-gjykime
- ✓ sipas nenit 55-56 (bashkime demnimesh) te K.P – 12-gjykime
- ✓ kerkesa per shuarje denimi, njohje amnistie, llogaritje paraburgimi,etj – 28-gjykime

Prokurori Shyqyri Duro

Hetuar -	30 proçedime penale
Mosfilluar –	10 kallzime
Derguar ne gjyq –	5 proçedime penale
Pushuar –	2 proçedime penale
Pezulluar –	3 proçedime penale
Transferuar -	0 - proçedime penale
Mbartur-	20 proçedime penale

Pjesemarrje ne gjykim me objekt kerkese :

- ✓ sipas nenit 64–59/a- 46 te K.P – 23-gjykime
- ✓ sipas nenit 59 (te demtuar akuzues) te K.P – 0-gjykime

- ✓ sipas nenit 66/ (parashkrimet) te K.P – 14-gjykime
- ✓ sipas nenit 504-512 te K.Pr.P (ekstradime-njohje vendimi te huaj – 0-gjykime
- ✓ Perfitim nga amnistia 4-gjykime

Prokurori Mediana Meta (Nga dt.01.07.2020-01.11.2020 me leje lindje)

Hetuar -	81 proçedime penale
Mosfillime –	39 kallzime
Derguar ne gjyq –	8 proçedime penale
Pushuar –	11 proçedime penale
Pezulluar –	32 proçedime penale
Transferuar -	2 proçedime penale
Mbartur-	28 proçedime penale
Zgjatje afatesh -	1 proçedim penale

Pjesemarrje ne gjykim me objekt kerkese :

- ✓ sipas nenit 64–59/a- 46 te K.P – 11-gjykime
- ✓ sipas nenit 59 (te demtuar akuzues) te K.P – 0-gjykime
- ✓ është ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë për nenin 64 të K.Penal ku Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënin në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
- ✓ sipas nenit 66/ (parashkrimet) te K.P – 19-gjykime
- ✓ sipas nenit 504-512 te K.Pr.P (ekstradime-njohje vendimi te huaj – 0-gjykime
- ✓ sipas nenit 55-56 (bashkime demnimesh) te K.P – 0-gjykime
- ✓ kerkesa per shuarje denimi, njohje amnistie, llogaritje paraburgimi etj – 6-gjykime

Gjate veprimtarise se punes se Prokuroreve duhet evidentuar si ngarkese dhe proçedimet penale per te cilat eshte vendosur pushimi per shkak parashkrimi gjithsej 93- vendime pushimi per shkak parashkrimi sipas nenit 66/ te K.Penal.

Duhet evidentuar dhe ngarkesa e **Of/Pol/Gjyqesore te seksionit te Prokurorise** Adrian Elezi dhe Flori Bajramaj qe kane perballuar nje ngarkese prej 163 -çeshtjes penale.

Of/Pol/Gjyqesore Adrian Elezi (i ngarkuar me zyren e regjistrit)

Hetuar 77 - çeshtje penale. (ngarkuar dhe me zyren e regjistrit), per te cilat:

- ✓ gjykates 26 çeshtje
- ✓ pushuar 14 çeshtje
- ✓ pezulluar 8 çeshtje
- ✓ Mbartur 26 çeshtje

Of/Pol/Gjyqesore Flori Bajramaj

Hetuar 86 - çeshtje penale, per te cilat :

- ✓ gjykates 24 çeshtje
- ✓ pushuar 27 çeshtje
- ✓ pezulluar 5 çeshtje
- ✓ Mbartur 30 çeshtje

Duhet evidentuar si problematike mos marrja ne çdo rast e fashikullit per veprime hetimore me urdher per kryerje veprimesh hetimore apo delegim te posaçem sipas nenit 304/2 te K.Pr.Penale, menjehere pa regjistrimit te çeshtjeve nga Prokuroret.

Ky moment eshte pergjegjesi dhe e Prokuroreve por dhe O.P.Gj te cilet nuk i trajtojnë rastet sipas procedurave ligjore, pasi veprime te tilla sjellin pavlefshmeri te akteve te perpiluara.

Eshte perballuar nje ngarkese e konsiderueshme nga Seksioni i Pol/Gjyqesore te Policise se Shtetit. (problematika do trajtohet me poshte tek marredheniet me sherbimet e Policise)

VII. Ekstradimet dhe Leter-porosite

Nje tjeter veprimtari qe duhet evidentuar jane dhe kerkesat per njohje vendimesh penale te autoriteteve te Drejtesise se shteteve te huaja, si leter-porosite e ndryshme.

Konkretisht rezultojne 2- raste procedurash te ndjekura me kerkese per ekstradim nga autoritetet e vendeve te tjera (Itali).

Rezultojne 7- raste procedurash te ndjekura me kerkese per njohje vendimi penal ne huaj ne Gjykate.

Per 3- raste eshte proceduar me veprime per leter-porosive nga autoritetet e huaja.

Te gjitha kerkesat e Prokurorise jane pranuar nga Gjykata, dhe nuk ka patur ne asnje rast problematika.

VIII. USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TE DREJTUESIT TE PROKURORISE.

Ne veprimtarine e ndjekjes penale per çeshtjet e hetuara dhe te perfaqesuara ne gjykim, nje rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorise, qe nga momenti i pare i vleresimit te akteve te referuara per problematikat e rasteve drejtim regjistrimit te çeshtjeve penale, me pas te kontrollit ne dinamike, analizave per rastet e diferencuara, si dhe krijimit te marredheneve me Prokuroret dhe Of/Pol/Gjyqesore, te seksionit te Prokurorise dhe seksioneve dhe sherbimeve te Policise, si dhe me Institucionet e tjera .

Gjate periudhes qe analizojme nga Drejtuesi i Prokurorise eshte ushtruar studimi i te gjitha materialeve kallzuese dhe te referuara nga Policia Gjyqesore e ato me vendngjarje, ne vleresim te problematikave, duke proceduar me pas me kalimin per shortim elektronik per regjistrimin e çeshtjeve apo verifikim.

Duhet nenvizuar fakti se ne te gjitha rastet, dhe per shkak te ngarkeses objektive me Gjykatën te Prokurorëve, nga Drejtuesi janë studiuar aktet e referuara fillimisht, duke evidentuar problematikat, dhe orientuar drejtimet e hetimit.

Ndryshimet ligjore, kanë bere qe Drejtuesi i Prokurorisë te marre me teper karakter organizativ.

Jane organizuar dhe kryer analiza per çeshtje te veçanta te here pas-hershme, dhe me sherbimet e policise per çeshtje te diferencuara, me problematika.

Gjate dinamikës se punës, nga Drejtuesi i Prokurorisë është terhequr vemendja por dhe urdheruar sherbimet e policise per trajtimin e rasteve, si ne paraqitjen e referimeve por dhe gjate hetimeve.

Gjithshtu është krijuar nje klime e mire bashkepunimi ne perballimin e ngarkeses, ndarjen e çeshtjeve sipas shortit, duke respektuar proporcionalitetin, dhe ne raste te veçanta per shkak ngarkese apo profilizimi te caktuar Prokurorë te ndryshem janë ngarkuar me çeshtje te veçanta.

Sa i perket problematikave ne hetim, vetem 3-raste rezultojne me kerkese per heqje dore nga prokurorët dhe zevendesimin e tyre me nje Prokuror tjetër.

Urdherat dhe udhezimet e Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, janë punuar dhe diskutuar per implementimin e tyre.

Eshte ushtruar kontroll ne dinamike te çeshtjeve penale gjate hetimeve paraprake, janë evidentuar dhe kerkuar verbalisht veprime konkrete qe duhet te kryhen.

Referuar udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem, janë nxjerre disa udhezime te detyrueshme ne funksion te organizimit te punës nga Drejtuesi i Prokurorisë.

IX. MARREDHENIET ME INSTITUCIONET

Krijimi i nje raporti ligjor te ngushte korrekt dhe profesional, ka shoqeruar marredheniet me Institucionet e tjera ligjzbatuese, ne veçanti me sherbimet e Komisarjatit te Policise Kavaje, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Kavaje dhe Prokurorine prane Gjykates se Apelit Durres.

Marredheniet qe burojne per shkak te veprimtarise dhe proçedurave ligjore, te hetimit dhe perfaqesimit ne gjygj, pra me Policine dhe Gjykatën, janë vleresuar si marredhenie bashkepunimi si ne aspektin organizativ ashtu dhe ate ligjor ne respektim te kryerjes se detyrave ne afate nga seksionet e Pol/Gjyqesore dhe sherbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektesine ne zhvillimin e seancave gjyqesore me Gjykatën.

Ne disa raste është mbajtur qendrim per problematika te ndryshme, te karakterit organizativ te punës, pa cenuar pamvaresine e institucioneve.

1. GJYKATA

Nuk janë evidentuar raste të shtyrjes së seancave gjyqesore për mosparaqitjen e Prokurorëve.

Nga ana e Gjykatës duhet vlerësuar bashkëpunimi me Prokurorët për përballimin e ngarkesës në gjykim.

Por :

Disa raste me zvarritje të proceseve janë evidentuar për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve, për shkak të përjashtimit të tyre, kur gjykohet me trup gjykues, pasi duhet të komandohen gjyqtarë nga Gjykatat e tjera, ku janë evidentuar vonesa në caktimin e gjyqtarëve duke bërë që të zvarritet procesi i gjykimit.

Në disa raste i kemi kërkuar Gjykatës një planifikim me të sakte të gjykimeve penale, të cilat për mendimin tonë duhen planifikuar në orët e para, dhe jo pas orës 14.00, pasi kanë lidhje me shoqërimin e të pandehurve, paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve etj.

Për shkak të një mbingarkese, në gjykimet me objekt “lirimet me kusht” nën 64 K.P, apo “qëndrimin në shtëpi” nën 59/a të K.P, i kemi kërkuar Gjykatës që këto raste duhen grupuar, pasi kërkojnë një kohë të shkurtër gjykimi, lidhen direkt me shërbimet e Policisë së Burgjeve, dhe shërbimet e provës. Për një kordinim dhe planifikim do të lehtësonte punën dhe kursente kohën dhe për Prokurorët.

Sic kemi nënvijëzuar edhe në analizat e tjera, gjykata ndodhet 2.5 km larg Prokurorisë, dhe kjo largësi shkeput Prokurorët nga zyra, duke e vështirësuar shumë arritjen e përmbushjes së të gjithë veprimtarisë hetimore, gjyqesore etj.

Përveç 141 -çështjeve të gjykuara themeli, janë trajtuar dhe 153 kërkesa për nën 64 – 59/a, etj (që përbejnë relativisht me shumë se 600-seanca gjyqesore), gjë që e bën tepër të vështirë aspektin “kohë” për ta shfrytëzuar në drejtim hetimor.

Këto problematika janë ngritur dhe në analizat e mëparshme, pasi shqetësimi ekziston ende për shkak të kësaj ngarkese dhe kushtesh.

2. ZYRA SHËRBIMIT TË PROVËS.

Marredhënia e Prokurorisë me zyrën e shërbimit të provës, lidhet për shkak të trajtimit të rasteve të gjykimeve me objekt lirimet para kohës me kusht, pra ekzekutimit të këtyre vendimeve.

Në rastet e kërkuara nga prokurorët dhe Gjykata në aplikimin e dënimit se dënimeve me kusht sipas nënit 59 të K.Penal, përgjithësisht janë raportuar verifikimet me një raport, i cili ka shërbyer me pas për të vlerësuar kushtet dhe kriteret llojin e dënimit.

Konkretisht mbi bazën e kërkesës së Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kavajë i është kërkuar gjykatës për 2-raste revokimi i dënimit me kusht.

3. SHERBIMET E POLICISE

Eshte vleresuar si e rendesishme ne fazen e njoftimit te Prokuroreve te gatshem sipas grafikut per vepra penale te karakterit te rende, por dhe te problematikave ligjore gjate veprimeve te para hetimore.

Pergjithesisht eshte reflektuar nje nivel i mire bashkepunimi.

Ne lidhje me materialet e referuara, shpesh evidentohen dhe mangesi te karakterit formal por dhe procedural.

- Ngritja e nivelit profesional të trupës së oficerëve të policisë gjyqësore duhet konsideruar si një nga elementët kryesorë për përmirësimin e punës. Evidentojme mangesi ne perpilimin e akteve (deri ne te shkruar), me veprime te shkeputura, marrje deklarimesh jo te plota, pa drejtuar pyetje specifike por duke marre thjesht deklarim historik, pa adresa të sakta të vendbanimit, etj.
- Proçes verbalet e sekuestrimit dhe vendimarrjet per kryerje ekspertimesh, rezultojne te pa njoftuara paleve.
- Kryerja ne kohe e veprimeve te paperseriteshme.
- **Nga sektori i krimit ekonomik apo per vepra penale me natyre korrruptive, rezulton se nuk ka referime per vepra penale ne kete fushe.** Nderhyhet vetem ne rastet kur evidentohen nga task-forcat e energjise elsktrike, duke kryer veprimet formale te konstatimit te faktit. Nuk ka referime ne fushen e tatimeve.
- Per vepren penale te parashikuar nga neni 287/ te K.Penal, per vitin 2020 nuk rezulton asnje referim.

Duhet evidentuar se sipas nenit 287 K.Pr.Penale “*regjistrimi i njoftimit te veprave penale*” parashikon qarte se behet fjale per fakte penale. Pra jo çdo fakt juridik, perben fakt penal per te cilen duhet te investohet Prokuroria. Evidentohen raste qe per te njejtin subjekt referohen dy-tre herë kallëzime penale të pashoqëruara me asnjë dokumentacion.

Mendoj se ne lidhje me keto raste duhet te behen ndryshime ligjore ne lidhje me organizimin e policise se shtetit, ku ratet qe nuk perbejne fakt penal, te regjistrohen ne regjistra te posaçem nga sherbimet, konform zgjidhjes ligjore qofte dhe ne aspektin administrativ.

Pra problematikat me shume rezultojne te karakterit profesional, gje qe ka vend per permiresim, pasi ne aspektin e komunikimit kur ngrihet nje problem, sherbimet e policise angazhohen dhe tregohen te gateshme.

4. ZYRA E PROKURORIT TE PERGJITHSHEM

Duhen evidentuar dhe marredheniet me Zyren e Prokurorit te Pergjithshem, ne funksion te zbatimit te urdherave dhe udhezimeve.

Evidentojme se nga nxjerrja e tyre kane gjetur zbatim dhe ndikuar ne mbarevajtjen e veprimtarise se Prokurorise ne hetimin e çeshtjeve dhe perfaqesimin ne gjykim, por dhe drejtim aspektit organizativ.

Duhet evidentuar fakti i nje bashkepunimi korrekt dhe me vlere per hetimet me zyren e S.P.M.T.Sh.I ne Prokurorine e Pergjithshme.

Evidentojmë faktin, se ne lidhje me korespondencat, transkriptimet, apo administrimin e CD, është krijuar një praktike e mire.

Per çdo rast evidentohet sakte ne regjistrin perkates te pergjimeve.

Per kete ka sherbyer dhe udhezimi i Prokurorit te Pergjithshem "Per pergjimet"

Me Drejtorine e Marredhenieve me Jashte, ka patur nje bashkepunim korrekt, pasi kete vit ka patur nje numer te konsiderueshem praktikash ekstradimesh dhe njohje vendimesh penale te huaja si dhe leterporosi (notifikime) nga autoritetet e drejtesise vendeve te tjera. (te trajtuara me siper)

• ADMINISTRATA

Ne mbarevajtjen e punes te veprimtarise se Prokurorise nje rol te rendesishem kryen dhe administrata e Prokurorise.

Duhet evidentuar se sa i perket zyres se regjistrit ku eshte ngarkuar Of.Pol/Gjyqesore z. Adrian Elezi, rezulton se jane mbajtur me korrektesi regjistrat perkates, jane derguar brenda afateve te percaktuara evidencat.

Eshte respektuar zbatimi i urdherit te Prokurorit te Pergjithshem ne lidhje me shortimin e kallzimeve dhe referimeve.

Duhet angazhuar me teper ne lidhje me ndjekjen e azhornimeve ne regjister, kjo mungese dhe e Prokuroreve.

Zyra e K/sekretarise ka perballuar volumin e protokolleve si dhe mbajtur evidencat financiare.

Rezulton se tashme ka nje ngarkese sa i perket kesaj zyre, per shkak te mbulimit te tre sektoreve, si te protokullit, finances dhe Arshiven e Prokurorise.

Me poshte po paraqesim dhe pasqyren e fondeve, shpenzimeve dhe te ardhurave per vitin 2020.

Fondi per vitin 2020	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi I pagave 600	31197100	31196013	99.99%
Fondi I Sigurimeve Shoq. Shendt. 601	3192000	3059581	99.50%
Fondi I shpenzimeve mallra e sherbime 602	5750000	5750000	100%
Fondi per transferta individuale 606	50000	50000	100%
Fondi I pagave ore jashte orari		1957809	
Fondi investimeve	0	0	0

Shpenzime procedurale te arketuara nga Prokuroria jane 4900 leke te cilet jane derdhur ne buxhetin e shtetit.

X. DREJTIMET DHE PRIORITETET E PUNES PER VITIN 2021.

- Rritja e integritetit te Prokuroreve dhe Of/Pol/Gjyq, me synimin e permiresimin e veprimtarise, dhe motivimit tyre.
- Angazhimi maksimal per hetimin dhe perfundimit e çeshtjeve te mbartura nga viti 2020.
- Bashkepunimi nder-institucional me te gjitha axhensite ligjzbatuese, te luftes kunder krimi, eshte nje nder elementet kryesore te arritjes se suksesit, dhe rezultateve te evidentueshme.
- Vleresimi i te gjitha materialeve qe referohen apo dhe informative qe vijne nga axhensite e ndryshme te sherbimeve inteligjente.
- Rritja e nivelit profesional te Prokuroreve dhe Of/pol/Gjyqesore, nepermjet trajnimeve te ndryshme dhe te specializuara, qe do te ndikonte ndjeshem ne rritjen e cilesise se veprimtarise hetimore dhe perfaqesimit ne gjykime.
- Reagimi dhe reflektimi nepermjet dokumentimit shkreserisht dhe ligjerisht, ndaj strukturave apo Institucioneve qe reflektojne mefshtesi dhe qendrimet jo-profesionale ne konfirmimet e tyre, apo dhe ndaj subjekteve eksperte per mungesen e korrektesise ne respektimin e afateve te formalizimit te akteve por dhe permbajtjes se tyre profesionale.
- Rritja e ushtrimit te kontrollit ne dinamike te çeshtjeve nga Prokuroret, por dhe kryerja e veprimtarise hetimore nga ana e tyre, si dhe ushtrimi i kompetencave nga Drejtuesi ne kontrollin dhe reagimin ligjor nepermjet udhezimeve te pergjithshme te detyrueshme por dhe udhezimeve per çeshtjet konkrete.

Prioritetet per vitin ne vazhdim 2021 :

Bazuar ne prioriteteve te shpallura nga Keshilli i Ministrave per luften kunder kriminalitetit, bazuar ne progres raportet dhe rekomandimet e partnereve te huaj, si dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem, duhen percakuar dhe prioritetet per vitin 2012 si me poshte :

- Lufta kunder korrupsionit, dhe krimi ekonomiko-financiar, si nje nga prioritetet dhe detyrat paresore, te punes tone, dhe kerkesave te kohes. Kjo detyre eshte aktuale, per te permbushur angazhimet qe ka Shqiperia ne kuadrin e integritetit ne strukturat e Bashkimit Europian, ndaj dhe roli i Prokurorisë si nje nga aktoret kryesore ne sistemin teresor te ushtrimit Drejtesise penale ne permbushjen e kesaj detyre eshte determinant.

- Evidentimi, vleresimi dhe hetimi i veprave penale te referuara apo te evidentuara kryesisht, qe lidhen me veprimtari korruptive, apo dhe te shperdorimit te detyres, te cilat kane te bejne me subjekte te administrates shteterore.
- Lufta kunder krimit te organizuar, ku duhet evidentuar se tashme Prokuroria ka regjistruar nje numer te konsiderueshem çeshtjes me objekt “hetimin pasuror|..” kaluar per kompetence nga ish-Prokuroria Pr Krime te Renda Tirane.
- Rritja e efikasitetit te ushtrimit te ndjekjes penale ndaj autoreve, qe dyshohen per vepra penale te natyres se trafikëve dhe pastrimit te produkteve, e cila duhet kordinuar me sherbimet e policise dhe axhensite e tjera ligjzbatuese. Duhet rakorduar dhe evidentuar me sherbimet e policise, subjektet te cilat mund te kene rekorde kriminale jashte teritorit te Shqipërisë, duke bashkepunuar me strukturat dhe axhensite e tjera qe administrojne keto te dhena, por dhe duke marre informacione nga policimi ne komunitet, deri ne evidentimin e nderrimit te emrave, ku pjesa dermuese e ketij kontigjenti ndodhen ne te tilla rrethana.
- Respektimi i dispozitave te K.Pr.Penale ne lidhje me trajtimin e rasteve gjate hetimit si te dyshuarve por dhe viktimave, duke respektuar me korrektesi detyrimet ligjore, te drejtat e tyre, por dhe duke reflektuar nje sjellje dhe komunikim si verbal por dhe ne kthimin e pergjigjeve te kerkesave te ndryshme, ne menyre korrekte . Ne veçanti te shtrsave vunerabel, per shkak te gjinise, me aftesi te kufizuar, por dhe te dispozitave te K.P.D per te mitur ne trajtimin e rasteve.
- Bashkepunimi nder-institucional, duhet te jete perparesi, duke shprehur se pari vullnet dhe krijuar nje klime bashkepunimi me axhensite ligjzbatuese, por dhe institucionet dhe faktoret e tjere informues. Evidentimi dhe trajtimi i çdo rasti me efikasitet ne luften kunder krimit, arrihet vetem nepermjet nje bashkepunimi te gjithë aktoreve ligjzbatues.

Duke ju falenderuar per vemendjen.

DREJTUESI I PROKURORISE

Artan MADANI